



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 19 tetor 2016

Numri i lëndës: 2014-34

Rejhane Sadiku-Syla

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 19 tetor 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

PROCEDURA

1. Kryesuesja e Panelit, znj. Magda Mierzewska, ka marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj lënde përmes komunikimit elektronik në përputhje me nenin 13(3) të rregullores së punës së Panelit.
2. Ankesa është regjistruar nga Kushtrim Istrefi, jurist, përfaqësues ligjor i znj. Rejhane Sadiku-Syla me 4 korrik 2014.
3. Më 27 gusht 2014, Paneli vendosi të njoftonte shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it Kosovë rreth ankesës, duke e ftuar atë të paraqes vërejtjet e tij me shkrim për ankesën.

4. Vërejtjet e ShM janë pranuar me 12 nëntor 2014, ku më pastaj u janë komunikuar ankueses për vërejtje shtesë nga ajo.
5. Me 1 dhjetor 2014, ankuesja ka dërguar vërejtjet e saja shtesë, të cilat më pas i janë dërguar ShM për informim.
6. Me 29 shtator 2015, Paneli ka shpallur ankesën të pranueshme. Paneli ka konstatuar se kjo ka ngritur çështje serioze të fakteve dhe të ligjit në bazë të nenit 2 (e drejta për jetën), 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërujes), neni 8 (respektimi i jetës private) dhe neni 13 (e drejta për zgjidhje efektive) i Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa"), përcaktimi i të cilave ka kërkuar një shqyrtim të meritave të ankesës. Paneli ka ftuar palët të paraqesin ndonjë vërejtje shtesë që mund të kenë pasur rreth meritave të lëndës.
7. Vërejtjet nga shefi i Misionit dhe ankuesja janë pranuar me 2 mars 2016 dhe përkatësisht me 11 prill 2016.

FAKTET

I. RRETHANAT E LËNDËS

8. Me 7 dhjetor 2000, babai i ankueses, z. Sylë Sadiku ishte zhdukur nga shtëpia e tij në pjesën veriore të Mitrovicës, ku ishte sulmuar nga një grup personash të armatosur që thuhet se kanë qenë të përkatësisë etnike serbe. Sulmi ishte parë nga motra e ankueses, e cila arriti të largohet dhe e cila më vonë ishte tërhequr nga trupat franceze të KFOR-it. Që nga ajo datë, ankuesja nuk ka pasur asnjë informacion rreth vendndodhjes dhe fatit të babait të saj.
9. Midis 8 dhjetorit 2000 dhe 17 shkurtit 2001, trupat franceze të KFOR-it dhe policia e UNMIK-ut morën disa deklaratë nga tre anëtarë të paspecifikuar të familjes së personit të zhdukur. Po ashtu ishte urdhëruar edhe një kontroll i zonës nga ajri. Këto hapa hetimorë ishin të pasuksesshëm dhe z. Sadiku apo mbetjet e tij nuk janë gjetur. Rasti mbeti i hapur, por joaktiv.
10. Në dhjetor të vitit 2008, baza e të dhënave të UNMIK-ut, dosjet dhe arkivat e tyre janë bartur në Departamentin e Mjekësisë Ligjore (DML) të EULEX-it. Dosja e lëndës lidhur me zhdukjen e babait të ankueses përfshinë raportin e pranisë së KFOR-it francez nga vendi i incidentit dhe raportin e incidentit të policisë së UNMIK-ut, duke përfshirë tre deklaratë të dëshmitarëve.

Megjithatë, duket se dosja e lëndës penale nuk ishte dorëzuar në prokurorinë e EULEX-it nga UNMIK-u. Nuk ka asnjë informacion lidhur me këtë lëndë në bazën e të dhënave të prokurorisë së EULEX-it.

11. Me 6 dhjetor 2013, ankuesja i ka dorëzuar një letër shefit të Misionit të EULEX-it (ShM) duke kërkuar informata mbi rrethanat e zhdukjes së babait të saj dhe duke e pyetur EULEX-in për informata rreth ndonjë hapi hetimor apo prokurorial të ndërmarrë në këtë lëndë.
12. Me 20 dhjetor 2013, ankuesja ka marrë një përgjigje nga Zyra e Shefit të Stafit të EULEX-it. Aty deklarohet se Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) i EULEX-it kishte konfirmuar se eshtrat e babait të ankueses ishin të pagjetura. Prandaj në DML lënda kishte mbetur aktive dhe e hapur. Megjithatë letra nuk ka adresuar pyetjet e ankueses lidhur me hapat hetimor apo prokurorial të ndërmarra në këtë lëndë.
13. Me 5 shkurt 2014, ankuesja ka dërguar një letër të dytë ShM-së, duke kërkuar sqarime mbi obligimin e prokurorëve të EULEX-it për të kryer një hetim penal efektiv rreth lëndës dhe duke paraqitur pyetje të tjera në lidhje me aspekte të ndryshme procedurale të hetimit.
14. Me 14 shkurt 2014, Zyra e Shefit të Stafit ka dërguar një përgjigje, ku thotë se ai mund vetëm ta përsërit informatën e dhënë në letrën e tij të datës 20 dhjetor 2013.
15. Me 26 mars 2014, ankuesja ka dorëzuar një letër tjetër, kësaj here i ka dorëzuar prokurorisë së EULEX-it të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) duke kërkuar zyrtarisht një hetim rreth rrethanave të zhdukjes së babait të saj.
16. Me 3 prill 2014, ankuesja ka marrë një përgjigje nga shefi i PSRK-së ku deklarohet se baza e të dhënave të tyre nuk ka përmbajtur asnjë informacion në lidhje me lëndën. Ai rekomandoj që ankuesja duhet të kontaktonte Ekipin Mobil të EULEX-it apo zyrën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për të verifikuar nëse ata kishin informata rreth lëndës.
17. Me 22 prill 2014, ankuesja ka paraqitur një kërkesë tek Ekipi Mobil i prokurorëve të EULEX-it me kërkesën që të hetohet zhdukja e babait të saj.
18. Me 13 qershor 2014, Ekipi Mobil i prokurorëve të EULEX-it ka informuar ankuesen se *“Baza e të dhënave e Zyrës së Prokurorisë së EULEX-it në Mitrovicë nuk posedon as informata rreth rastit e as informata rreth veprimeve që mund të jenë kryer në këtë lëndë”*. Ekipi Mobil po ashtu ka treguar se çështja nuk ka hyrë në kuadër të kompetencave të Zyrës së Prokurorisë së EULEX-it, pasi kjo kishte të bënte me një çështje penale, e cila duhej të raportohet në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, ku dhe e kishin referuar lëndën.

II. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i KOSOVË do të ndihmoj institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar që këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i KOSOVË do të:

(...)

(h) merr përgjegjësi të tjera, qoftë ndarazi ose në bashkëpunim me autoritetet kompetente të Kosovës, për të siguruar zbatimin dhe promovimin e sundimit të ligjit, të rendit publik dhe sigurisë, në konsultim me agjencitë përkatëse të Këshillit; dhe

Ligji nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (e vlefshme deri me 30 maj 2014)

Neni 3 Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale

(...)

3.3. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë apo që punon në ekipin e përzier të identifikuar në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit të gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përjashtimin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të parapara sipas KPPPK-së (neni 40-44 i KPPPK-së), Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, çdoherë kur konsiderohet e nevojshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë, që t'i caktoj gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligj, për krimet e poshtëshënuara, atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhet nga PSRK-ja:

(...)

h) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK)

Neni 12 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë së prokurorëve publik të Kosovës

12.1. Në secilën fazë të çdo procedure penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtrojë detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikojë hetimin apo ndjekjen e duhur të një vepre penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një vepre penale, Kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkojë nga Kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktojë: a) një prokurori tjetër publik të Kosovës që punon në të njëjtën zyre prokuroriale, b) apo cilitdo prokuror të EULEX-it që do të merr përgjegjësinë për hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.

12.2. Nëse Kryeprokurori i zyrës kompetente kundërshton kërkesën e Kryeprokurorit të EULEX-it, Kryeprokurori i EULEX-it do ta njoftojë Kryeprokurorin publik të Kosovës dhe së bashku do të marrin një vendim të përbashkët, i cili do të respektohet nga Kryeprokurori i zyrës kompetente.

12.3. Në rrethana urgjente ose kur vonesa mund të ndikojë në kryerjen apo rezultatin e hetimit, ndjekjen penale apo zhvillimin e drejtë të procedurës, Kryeprokurori i EULEX-it do të ketë të drejtë që të ndërmerr çfarëdo veprimi urgjent procedural apo të caktojë cilindo prokuror të EULEX-it apo prokuror publik të Kosovës për një qëllim të tillë.

Ligji nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës

Neni 3 Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (e zbatueshme prej datës 31 maj 2014)

.....

3. Pas nenit 1 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 1.A me tekstin në vijim:

Neni 1.A Rastet në proces

Për qëllime të këtij ligji, rast në proces e sipër nënkupton:

1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin.

2. Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.

.....

9. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 7 Autoriteti dhe kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1. Prokurorët e EULEX-it do të kenë autoritet dhe përgjegjësi t'i kryejnë funksionet në zyrën e tyre, përfshirë autoritetin për kryerjen e hetimeve penale ashtu siç përcaktohet në nenin 2.1 të këtij ligji, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.

7.2. Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetentë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të PSRK-së në pajtim me ligjin mbi PSRK-në.

7.3. Prokurorët e EULEX-it janë të integruar në sistemin prokurorial të Kosovës dhe do të ushtrojnë funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

7.4. Rastet e udhëhequra nga prokurorët e EULEX-it të përcaktuara në nenin 2.1 të këtij ligji do të vazhdojnë të menaxhohen në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (2008) dhe të Ligjit për PSRK-në (2008).

7.5. EULEX KOSOVË do të caktoj prokurorë që të ndihmojnë lidhur me zbatimin, sipas marrëveshjes, të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga BE-ja.

7.6. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, prokurorët e EULEX-it do të konsultohen dhe bashkërendojnë ngushtë aktivitetet e tyre me Kryeprokurorin përgjegjës të zyrës, të cilën ata janë të vendosur.

....

10. Pas nenit 7 të ligjit bazik, shtohen dy nene të reja 7.A dhe 7.B me tekstin si në vijim:

Neni 7.A Autoriteti i prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme.

Në rrethana të jashtëzakonshme një rast do t'i caktohet një prokurori të EULEX-it me vendim të përbashkët të Kryeprokurorit të shtetit dhe autoritetit kompetent të EULEX-it KOSOVË.

Ligji nr. 03/L-052 për Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

Neni 5 Kompetenca e veçantë e PSRK-së

5.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë të veçantë që të hetoj dhe ndjek penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si vijon:

.....

e) krimet kundër njerëzimit (neni 117, KPPK);

f) krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës (neni 118, KPPK), krimet e luftës si shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPPK), krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës (neni 120, KPPK), krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar (neni 121, KPPK);

...

n) krimi i organizuar (neni 274, KPPK), kërcënimi gjatë procedurave penale për krim të organizuar (neni 310, KPPK);

.....

Neni 9 Kompetenca plotësuese e PSRK-së

9.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë plotësuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si në vijon:

.....

b) nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik (neni 115, KPPK);

.....

h) vrasja (neni 146, KPPK), vrasja e rëndë (neni 147, KPPK);

i) marrja e pengjeve (neni 143, KPPK);

j) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK);

k) rrëmbimi i personit (neni 159, KPPK);

.....

III. ANKESAT

19. Ankuesja pohon se EULEX-i ka shkelur të drejtat e saja sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) të pjesëve procedurale të tyre.
20. Në veçanti, ankuesja deklaron se prokuroria e EULEX-it ka dështuar të filloj ndonjë hetim në përputhje me ligjin e Kosovës dhe mandatin e EULEX-it, ka vonuar së tepërmi procesin hetimor dhe e ka referuar çështjen tek prokurorët vendorë duke neglizhuar seriozitetin e lëndës, vendndodhjen gjeografike të krimit (Mitrovica veriore) dhe elementet ndëretnike të krimit.

LIGJI

21. Ankuesja supozon se veprimet e EULEX-it kanë shkelur nenin 2 dhe 3 të Konventës. Në këto dispozita për aq sa janë përkatëse thuhet:

Neni 2 - E drejta për jetën

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit, kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji.

Neni 3 - Ndalimi i torturës

“Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.

22. Për shkak të përmbajtjes së ankesës dhe informatave të pranuar nga palët, Paneli ka vendosur ta komunikoj lëndën dhe ta shqyrtoj atë edhe sipas neneve 8 dhe 13 të Konventës, ku thuhet si më poshtë:

Neni 8 - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtë që t'i respektohet jeta private e familjare (...)
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike kjo masë është e domosdoshme për sigurinë kombëtare, për sigurinë publike, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.

Neni 13 - E drejta për ankim efektiv

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Parashtrësit nga palët

Shefi i Misionit ("ShM")

23. Në përgjigjen e tij ndaj pyetjes së Panelit nëse prokuroria e EULEX-it mund të jetë kompetente për të ndjekur penalisht çështjen në bazë të "rrethanave të jashtëzakonshme" të nenit 7(A) të Ligjit të ndryshuar mbi Kompetencat (*Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, nr. 2014-34, vendimi mbi pranueshmëri të datës 29 shtator 2015, konkluzion), shefi i Misionit (ShM) është përgjigjur se "rrethanat e jashtëzakonshme" brenda kuptimit të kësaj dispozite hollësisht ishin dhënë në Udhëzimin Administrativ për Prokurorinë Speciale të Kosovës për Përshkrimin dhe Caktimin e detyrave dhe Mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet Kryeprokurorit të PSRK-së dhe Zëvendës Kryeprokurorit të PSRK-së (EULEX) rreth administrimit dhe menaxhimit të PSRK-së. Sipas nenit 4.4, këto rrethana të veçanta përfshijnë: "mosgatishmërinë apo paaftësinë e prokurorit të Kosovës; ekspertizën dhe përvojën e prokurorit të EULEX-it që të sigurojë hetimin e duhur të ndjekjes penale të lëndës në fjalë; se ekziston dyshimi i bazuar i përpjekjeve për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen penale; se çështja nën hetime prek interesat e shteteve anëtare të BE-së apo të stafit të EULEX-it në Kosovë. "Aty ku këto kërkesa janë konsideruar se janë plotësuar, një kërkesë e hollësishme është dashur që t'i drejtohej Kryeprokurorit të Shtetit apo Kryeprokurorit të EULEX-it, duke theksuar rrethanat e pretenduara të jashtëzakonshme. Vendimi për të zbatuar nenin 7(A) në një rast të veçantë është marrë bashkërisht nga këta dy prokurorë dhe kjo nuk i binte vetëm prokurorit të EULEX-it që të vendoste për ta marrë përsipër lëndën.
24. ShM ka deklaruar se dosja e hetimit penal për zhdukjen e babait të ankueses asnjëherë nuk ishte bartur nga UNMIK-u në EULEX dhe prandaj asnjëherë nuk ishte hetuar nga prokurorët e EULEX-it. Dukej se i vetmi informacion sa i përket hetimit ishte gjetur në bazën e të dhënave të DML-së, ku thuhej se lënda kishte mbetur e hapur, por joaktive.
25. ShM më tej ka pohuar se babai i ankueses ishte zhdukur pas përfundimit të konfliktit, kështu që rasti i tij nuk i përkiste kategorisë së krimeve të luftës, por krimeve të tjera të rënda mbi të cilat PSRK-ja kishte vetëm kompetencë plotësuese.
26. ShM më tej ka sugjeruar se pas përfundimit të mandatit të tij UNMIK-u kishte bartur në EULEX edhe të ashtuquajturat lëndët "aktive" (lidhur me hetimet në vazhdim e sipër) e edhe dosjet "joaktive". Megjithatë dosjet e lëndëve që ishin të ndërprera dhe/ose hedhura poshtë apo të bartura nga UNMIK-u tek autoritetet e Kosovës nuk i ishin dhënë EULEX-it. Prandaj fakti që EULEX-i nuk ka poseduar ndonjë dosje të caktuar nuk ka pasur të bëjë me organizimin e Misionit. Të gjitha dosjet e pranuar nga UNMIK-u ishte shqyrtuar nga prokurorët e EULEX-it, pavarësisht prej statusit të tyre.

27. ShM ka konkluduar se EULEX-i nuk kishte shkelur të drejtat e ankueses. Edhe pse ishte mandati i Misionit për të hetuar krimet e luftës dhe krimet e tjera të rënda, do të ishte joproporcionale dhe joreale të pritej që EULEX-i të ndjekë penalisht dhe t'i zgjidhë të gjitha rastet në pritje. Sipas ShM, nuk i takonte EULEX-it që të gjithë viktimave të krimeve që ndërlidhen me konfliktin t'ju siguroj mjete efektive juridike ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre prej organizatave të tjera apo prej autoriteteve të Kosovës. Fakti që babai i ankueses ishte ende i regjistruar si person i zhdukur në bazën e të dhënave të Departamentit të Mjekësisë Ligjore nuk e bën EULEX-i përgjegjës për dështimin që të hetohet rasti.

Ankuesja

28. Në përgjigje, ankuesja ka hedhur poshtë argumentin e ShM se lënda nuk ka hyrë brenda dispozitave të nenit 7(A) të Ligjit të ndryshuar mbi kompetencat. Ajo theksoj se Prokurorisë së Kosovës i ka munguar gatishmëria dhe aftësia për të hetuar rastet e zhdukjeve të detyruara, siç pranohet në Raportin e Progresit 2015 të BE-së për Kosovën. Për më tepër Prokuroria e EULEX-it kishte përvojë dhe ekspertizë që të siguroj hetimin e duhur dhe ndjekjen penale në rastin në fjalë.
29. Për më tepër, ankuesja argumentoj se natyra e lëndës e ka bërë të domosdoshme që ajo të trajtohej në bazë të nenit 7(A), pasi ajo kishte të bënte me zhdukje të detyruar. Obligimi për të hetuar raste të tilla dhe për të ndëshkuar ata që janë përgjegjës, si në kohë lufte dhe paqeje, ka arritur statusin *jus cogens* dhe se ishte e rëndësishme që autorët e krimit të akuzoheshin për zhdukje të detyruar e jo për vepra të tjera penale, siç janë rrëmbim apo vrasje.

Vlerësimi i Panelit

Faktorët e përgjithshëm ligjor

30. Paneli tashmë ka pasur rastin të theksoj se Misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohen në të gjitha aspektet përkatëse në atë që mund të pritet nga një shtet (PShDNj, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11, 2014-12, 2014-13, 2014-14, 2014-15, 2014-16 dhe 2014-17, cituar më lartë, § 72; shih gjithashtu L.O. kundër EULEX-it, nuk ka 2014-32, 11 nëntor 2015, § 42; krahasoni gjithashtu opinionin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, § 35). Kjo është kështu për shkak se Misioni nuk posedon të gjitha atributet dhe burimet, zakonisht që janë në dispozicion të shteteve në kryerjen e funksioneve të tyre qeverisëse. Megjithatë, në atë masë që Misioni ka mandatin dhe burimet përkatëse dhe të nevojshme për të përmbushur një funksion të ngjashëm me atë të një qeverie, si pjesë e funksioneve ekzekutive, është e nevojshme për t'i zbatuar ato në përputhje me standardet e aplikueshme të të drejtave të njeriut.

31. Paneli gjithashtu merr parasysh vështirësitë që domosdoshmërisht përfshihen në hetimin e krimeve të rënda në një shoqëri të pas konfliktit siç është Kosova (shih Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ), *Palić kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, nr. 4704/04, 15 shkurt 2011 § 70, *mutatis mutandis*; Opinioni i PKDNJ-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, të cituara më lartë, §§ 44 dhe 62 e më tutje dhe opinionin e vet në lëndët nr. 168/09, 169/09 dhe 312/09, 6 qershor 2013, § 77; PShDNJ, L.O. kundër EULEX-it, cituar më lartë, § 44). Një situatë e tillë mund në të vërtetë të komplikoj kërkimin e provave, mbrojtjen e dëshmitarëve ose kryerjen e detyrave të caktuara hetimore apo detyrat e mjekësisë ligjore. Megjithatë fakti që është duke u zhvilluar një hetim apo ndjekje penale në një situatë pas konfliktit nuk mund të shpjegojë secilën dhe çdo mangësi hetimore përveç nëse ato janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me vështirësi të veçanta që lidhen me atë situatë. Prandaj Paneli në secilin rast vlerëson nëse një hap i veçantë hetimor që normalisht ishte i hapur do të kishte qenë i pamundur ose jopraktik prej shkaqeve që lidhen me rrethanat pas konfliktit pavarësisht prej atyre që e kryejnë hetimin.
32. Për më tepër, si mision i sundimit të ligjit, EULEX-i pritej që t'i kushtoj vëmendje të veçantë domosdoshmërisë për korrigjim, mirëmbajtje dhe forcim të sundimit të ligjit. Hetimi efektiv dhe ndjekja penale e krimeve të rënda është karakteristikë e veçantë e rëndësishëm e këtij aspekti të mandatit të EULEX-it. Prandaj është thelbësore që Misioni duhet të interpretoj kërkesën e “rrethanave të jashtëzakonshme” brenda kuptimit të nenit 7(A) të ligjit nr. 03/L-053 mbi Kompetenecat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve (shih ligjin përkatës në fuqi) në një mënyrë e cila është në përputhje me përmbushjen e këtij mandati. Ka pak dallim në mes të aftësisë së një shteti apo një Misioni të sundimit të Ligjit për ta ndarë sipas prioritetit hetimin e krimeve të tilla dhe për t'i kushtuar kohë dhe burime të mjaftueshme këtij prioriteti operativ (shih PShDNJ, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, cituar më lartë, § 75; L.O. kundër EULEX-it, cituar më lartë, §§ 46-47).
33. Zhdukja e detyruar është në të njëjtën kohë një krim i rëndë dhe shkelje e të drejtave të njeriut. Ajo përfshinë një lloj shkelje të shumëfishtë të të drejtave themelore të njeriut, në veçanti të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personave, të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës, ndalimin e arrestimit ose paraburgimit arbitrar, dhe të drejtën për një të gjykim të drejtë dhe publik” (Rezoluta nr. 828 (1984) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, § 4). Prandaj, zhdukja e detyruar konsiderohet të jetë një nga format më të rënda të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe është përshkruar si një “fyerje e dinjitetit njerëzor” dhe një “shkelje e rëndë dhe e neveritshme ndaj dinjitetit të qenies njerëzore” (Konventa ndër-amerikane lidhur me zhdukjen e detyruar të personave, 1994, Preambulë).
34. Me kalimin e kohës, ndalimi i “zhdukjes” është konsideruar si një garanci e pavarur dhe i vetëqendrueshëm, i obligueshëm për shtetet

si çështje e të drejtave themelore të njohura universale. Kjo është reflektuar në instrumente të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare dhe në praktikën gjyqësore të organeve të rëndësishme të të drejtave të njeriut. Për shkak të seriozitetit të saj, ka edhe një pranim në rritje se një akt i zhdukjes mund të përbëjë, në rrethana të caktuara, një krim ndaj njerëzimit (e njohur në nenin 7(1)(i) të Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare). Thelbi i kësaj vepre nuk është vetëm se ajo përbën shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut të personit të zhdukur (dhe të afërmeve të tyre); ajo është e lidhur edhe me reagimet dhe qëndrimet e autoriteteve ndaj asaj situate kur ajo ishte sjellë në vëmendjen e tyre (GjEDNj, *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, kërkesa nr. 16064/90 dhe të tjerët, aktgjykimi i datës 18 shtator 2009, par. 200; shih gjithashtu, *Orhan kundër Turqisë*, nr. 25656/94, § 358, 18 qershor 2002, dhe *Imakayeva kundër Rusisë*, nr. 7615/02, § ..., GjEDNj 2006-XIII (pjesë e shkëputur), § 164).

35. Viktimat e akteve të tilla nuk kufizohen vetëm për të zhdukurit, por mund të përfshijë edhe të afërmit e personave të zhdukur, të cilët vuajnë nga ankthi i vazhdueshëm që nuk dinë për fatin e të dashurve të tyre (shih në kontekstin e nenit 3 të KEDNj-së, *Kurt kundër Turqisë*, vendimi i datës 25 maj 1998, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1998-III, §§ 130-34; *Khadzhialiyev dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 3013/04, §§ 120-121, 6 nëntor të vitit 2008, shih edhe Rezolutën nr. 828 (1984), cituar më lartë, § 2). Është thelbësore që autoritetet të jenë të kujdesshme për shqetësimet emocionale me përfshirjen e këtyre të afërmeve në procese të tilla hetimore, (shih GjEDNj, *Orhan kundër Turqisë*, nr. 25656/94, § 358, 18 qershor 2002). Gjatë vlerësimit të përgjegjësisë së autoriteteve në lidhje me raste të tilla, cënueshmëria e veçantë e kësaj kategorie të viktimave duhet që detyrimisht të merret parasysh.
36. Rrjedhimisht, reagimi i pritshëm i autoriteteve - në këtë rast Misionit - duhet të jetë proporcional me seriozitetin e shkeljes së pretenduar dhe rëndësinë e të drejtave të mbrojtura. Në rastin e zhdukjeve, kjo do të përfshinte, në rrjedhën normale të ngjarjeve, një detyrim nga ana e autoriteteve kompetente për të hetuar me zell, menjëherë dhe në tërësi lëndët e tilla me qëllim të vendosjes së fatit të viktimës (primare) dhe për të ndjekur penalisht, gjykuar dhe ndëshkuar ata që gjenden se janë përgjegjës (shih për shembull *Nydia Erika Bautista de Arellana kundër Kolumbisë*, Komunikimi nr. 563/1993, Pikëpamjet e Komitetit të të Drejtave të Njeriut, 27 tetor 1995 par. 8.6). Kjo përpjekje hetimore duhet të synojnë dhe të jetë në gjendje të qartësoj vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur dhe siç mund të jetë rasti të identifikoj ata që janë përgjegjës për një vepër të tillë (shih p.sh. *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lartë, par. 191; *Ogur kundër Turqisë* [GC], nr. 21594/93, § 88, KEDNj 1999 III; *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 24746/94, §§ 105-09, 4 maj 2001; dhe *Douglas-Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 56413/00, 8 janar 2002). Në këtë kontekst, Paneli thekson se trajtimi i shpejtë i rasteve të tilla nga autoritetet - në lidhje me fillimin e një hetimi, sjelljen dhe finalizimin e saj - është jetike për

ruajtjen e besimit të publikut në respektimin e tyre të sundimit të ligjit dhe në parandalimin e dukjeve të konspiracionit apo tolerimit të veprave të paligjshme (shih vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, të cituar më lartë, § 80).

37. Në rastet e këtij serioziteti, autoritetet hetimore duhet të vënë fonde në përputhje me nevojën dhe mundësinë e zgjidhjes së çështjes (*L.O. kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 47). Përderisa nuk pritet nga asnjë autoritetet hetues që të zgjidhë të gjitha çështjet e sjella para tij, pritet nga ta që në secilin rast të veprojnë me zell, shpejtësi dhe efektivitet të tillë që pasqyron seriozitetin e çështjes që është duke u hetuar (shih *Varnava dhe të tjerët*, të cituar më lartë, § 191, KEDNj 2009; *Palić kundër Bosnjë e Hercegovinës*, cituar më lartë, § 63).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit

38. Paneli tani do të shqyrtoj ankesën lidhur me dy faza të veçanta: së pari: para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, dhe së dyti: pasi që ai ligj u bë i aplikueshëm. Paneli edhe një herë thekson se nuk është kompetent për të shqyrtuar zhdukjen në vete të të afërmit të ankueses për të cilën EULEX-i nuk mund të mbahen përgjegjës për arsye të dukshme. E Paneli as nuk do të konsideroj dështimin fillestar që të bëjë hetimin, që mund t'i atribuohet autoriteteve të tjera të mëparshme para krijimit të Misionit të EULEX-it. Paneli do t'i marrë parasysh vetëm ato veprime dhe mosveprime të vetë Misionit që thuhet të kenë ndodhur nga momenti në të cilën Misioni ka filluar të funksionoj (shih *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi pranueshmëri i datës 29 shtator 2015, § 50).
39. Për sa i përket periudhës së parë, Paneli ka pasur rastin t'i theksoj detyrimet e Misionit për të regjistruar me zell dhe nga ana tjetër t'i regjistroj në mënyrë të rregullt ankesat e sjella zyrtarisht dhe për t'i komunikuar ato organeve kompetente në kuadër të Misionit (shih PShDNj, *Becić kundër EULEX-it*, 2013-03, 12 nëntor 2014, §§ 58-60, *mutatis mutandis*). Misioni është gjithashtu përgjegjës për të siguruar që dorëzimi i dosjeve nga UNMIK-u tek EULEX-i dhe organizimi i dosjeve të lëndës të bëhet në mënyrë të tillë që siguron kryerjen efektive të funksionit të Misionit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në atë kontekst (shih p.sh. vendimin e pranueshmërisë në *Sadiku-Syla*, cituar më lartë, § 61).
40. Në rastin konkret, siç u përmend më lartë (§ 10) dhe në vendimin e pranueshmërisë të dhënë në këtë lëndë nga ana e Panelit (§ 51), informacioni në lidhje me këtë rast ka qenë në posedim të Misionit që nga viti 2008 (edhe pse në kuadër të kornizës së degës së mjekësisë ligjore). Mbi këtë bazë, Misioni duhej të kishte siguruar përmes organizimit të duhur dhe komunikimit në mes degëve të veta të ndryshme që informacioni i kësaj rëndësie t'iu komunikohet autoriteteve kompetente hetimore. Nuk është argumentuar nga

EULEX-i, e lëre më treguar, se ka pasur ndonjë komunikim mes DML-së dhe autoriteteve të prokurorisë rreth ndonjë hapi të mundshëm që do të merret në lidhje me zhdukjen e babait të ankueses. Në këtë lëndë, ShM nuk ka ofruar ndonjë shpjegim pse informatat e rëndësishme që ishin në dispozicion të DML-së nuk i ishin dhënë organeve hetimore të Misionit.

41. Paneli në këtë kontekst gjithashtu thekson si në vijim. Nuk mund të pritet nga një person që pretendon shkelje të këtij lloji të kryen hetimin e lëndës së tij/saj, e as nuk duhet që atij/asaj t'i kërkohet që të kontrolloj ose konsultohet me institucionet e ndryshme me shpresën që të identifikoj personin, i cili mund të jetë përgjegjës për këtë rast (shih gjithashtu PShDNj, *L.O. kundër EULEX-it*, rasti nr. 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 63). Për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut në këto lloje të rasteve, është e domosdoshme që përgjegjësia për t'i bashkërenduar përpjekjet hetimore (dhe të prokurorisë) është dhe mbetet mbi vetë autoritetet. Ata, dhe jo viktimat, mbajnë përgjegjësinë për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave të atyre që kanë vuajtur dëmin.
42. Paneli konkludon se për shkak të dështimit të Misionit për të siguruar që informacioni përkatës të silllej në vëmendjen e degëve të veta hetuese dhe prokuroriale, mund të thuhet se nuk ka ndodhur asnjë hetim i duhur rreth kësaj lënde gjatë periudhës së parë të kohës në shqyrtim e sipër.
43. Për sa i përket periudhës pas hyrjes në fuqi të ligjit për ndryshimin e Ligjit mbi kompetencat, Paneli merr pikëpamjen si në vijim. Siç është cekur nga Paneli në një rast të mëparshëm, Neni 7 (A) i Ligjit nr. 04/L-273 i jep prokurorisë së EULEX-it aftësinë për të zbatuar ndonjë përjashtim nga parimi i përgjithshëm që lëndët të cilat nuk janë konsideruar si lëndë në vazhdim e sipër nga data 14 prill 2014 duhej të trajtoheshin nga autoritetet e Kosovës (krahasoni *X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it*, 2011-20, § 64). Kjo dispozitë nuk mund të rezultojë në prishjen ose kufizimin e përgjegjësisë së Misionit për të vepruar në çdo kohë në përputhje me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut (shih p.sh. *H & G kundër EULEX-it*, 2012-19 dhe 2012-20, 30 shtator 2013 §§ 41 e tutje).
44. Në mesin e faktorëve të rëndësishme për ekzistencën e “rrethanave të jashtëzakonshme” janë si në vijim: së pari, nëse është kryer ndonjë hetim efektiv i rastit deri në atë pikë. Një përgjigje negative do të ndikonte tek prokurorët e EULEX-it që ushtrojnë kompetencat e tyre “të jashtëzakonshme”. Në rastin në fjalë, nuk është argumentuar e lëre më treguar se rasti ka qenë ndonjëherë objekt i ndonjë hetimi efektiv gjatë ndonjë periudhe të konsiderueshme kohore nga ndonjë organi. Së dyti, është e rëndësishme nëse çështja ka të bëjë me të drejtat e rëndësishme dhe shkeljet e rënda. Faktorët e tillë prapë do të peshojnë në favor të përfshirjes së “jashtëzakonshme” të prokurorëve të EULEX-it. Çështja në shqyrtim ka të bëjë me të drejtat themelore. Gjithashtu ka qenë një mundësi shumë reale që zhdukja e babait të

ankueses ishte e bazuar në baza etnike apo fetare, duke hyrë më tej në fushën e juridiksionit mbi të cilin Misioni ka kompetenca. Në një mjedis pas konfliktit ku marrëdhëniet etnike dhe fetare mund të jetë ende të tensionuara dhe të brishta, lëndët e tilla janë prioritete të qarta hetimore. Për më tepër, faktet themelore të çështjes në fjalë shkojnë tek në dhjetor të vitit 2000. Ankuesja është dashur të jeton që atëherë me trauma dhe shqetësime emocionale duke mos ditur për fatin e babait të saj. Edhe kjo, sipas të dhënave, nuk duket se është konsideruar e rëndësishme për Misionin në përcaktimin e “rrethanave të jashtëzakonshme”. Së treti, në qoftë se prokurorët e EULEX-it vendosin që mos të ushtrojnë kompetencat e tyre “të jashtëzakonshme”, lind pyetja nëse ka ndonjë mundësi të vërtetë dhe reale që autoritetet vendore të kryenin përgjegjësinë e tyre në lidhje me këtë rast. Në këtë lëndë, nuk ka asnjë tregues se është kështu ose në çfarëdo rasti nuk duket se janë ndërmarrë hapa me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante për ekzistencën e një mundësie të tillë (shih gjithashtu *X dhe 115 ankuesit e tjerë*, § 66). Së fundi, në këtë rast konkret, dështimi që të sigurohej bartja e informacionit përkatës për këtë rast nga një organ i Misionit në një tjetër i atribuohet vetë Misionit. Kjo e rrit sugjerimin se rrethanat e rastit janë “të jashtëzakonshme” sipas kuptimit të nenit 7(A) të Ligjit nr. 04/L-273.

45. Ligji i jep autoriteteve ndjekëse të EULEX-it kompetencë diskrecionale për t'i marrë përsipër lëndët të cilat ata për nga natyra i konsiderojnë të jashtëzakonshme. Kjo nuk i takon Panelit që të zëvendësoj autoritetet e EULEX-it në zbatimin e këtij kriteri. Megjithatë diskrecioni i Misionit në këtë drejtim nuk mund të ushtrohet në mënyrë arbitrare, pa i marrë parasysh të gjithë faktorët dhe rrethanat përkatëse. Ajo duhet të ushtrohet në një mënyrë që është në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Në këtë rast, nuk është argumentuar e lëre më treguar se ishte marrë parasysh nga autoritetet e ndjekjes të EULEX-it çështja nëse rrethanat e rastit kanë bërë të nevojshme që ato të cilësohen si “të jashtëzakonshme” për qëllimet e këtij statuti.
46. Në përfundim, Paneli pranon *prima facie* që rrethanat e rastit mund të konsiderohen se bien në kuadër të “rrethanave të jashtëzakonshme” të nenit 7(A) të Ligjit të ndryshuar mbi Kompetencat dhe se për këtë arsye Misioni do të mbetet kompetent në parim për t'i hetuar ato pas ndryshimit të Ligjit mbi Kompetencat. Për këto arsye, Paneli konstaton se shkelja e të drejtave të ankuesve nga Misioni ka vazhduar edhe pas ndryshimit të këtij ligji për shkak të dështimit të shqyrtimit të kësaj lënde sipas kësaj dispozite.

PËRFUNDIM

47. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit që janë parë si tërësi, Paneli konstaton se përpjekjet hetimore të EULEX-it ishin të pamjaftueshme dhe kanë rezultuar në shkelje të të drejtave të ankueses, të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në lidhje me të drejtat për

jetën dhe ndalimin e torturës dhe me nenin 13, të drejtën për mjete efektive, në lidhje me nenin 2 të Konventës.

48. Duke pasur parasysh konstatimet rreth neneve 2, 3 dhe 13 të Konventës, Paneli konsideron se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet lënda edhe sipas nenit 8 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI,

1. *Vendos* se ka pasur shkelje të neneve 2 dhe 3, dhe të nenit 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës; dhe
2. *Gjen* të përshtatshme, në bazë të gjetjeve të tij të mësipërme të fakteve dhe ligjit, që të bëjë rekomandimet e mëposhtme për shefen e Misionit sipas Rregullës 34 të Rregullores së punës:
 - a. ShM duhet të bëjë një deklaratë që pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses, që i atribuohen veprimeve [dhe/ose mosveprimeve] të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.
 - b. ShM duhet t'i udhëzoj të gjitha organet e Misionit që janë në kontakt me viktimat e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në kuadër të zhdukjeve të detyruara për të siguruar që në të gjitha komunikimet me ta, ata të komunikojnë me shpejtësinë, zellin e duhur dhe kujdesin e nevojshëm për të marrë parasysh shqetësimin emocional të bashkëbisedues(ve)it të tyre. Nëse është e nevojshme, ShM duhet të konsideroj zbatimin e udhëzimeve të cilat përcaktojnë në mënyrë më të hollësishme se çfarë mund të nënkuptojnë ky udhëzim i përgjithshëm në rrethana konkrete.
 - c. Paneli është plotësisht i vetëdijshëm për sfidat dhe vështirësitë që rezultojnë nga reduktimi i burimeve të Misionit për shkak të rikonfigurimit, etj. Megjithatë, brenda kufijve të këtyre burimeve dhe në mënyrë proporcionale me rëndësinë që Misioni i jep mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, Paneli fton ShM të siguroj që organet hetuese brenda Misionit të kenë në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme dhe mbështetjen për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë të përfshirëve.
 - d. ShM duhet t'i udhëzoj organet hetimore të EULEX-it mbi rëndësinë e rasteve të zhdukjeve që vazhdojnë të

jenë prioritet i hetimeve në mënyrë që ato të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe se kudo që të dyshuarit të identifikohen të sillen para drejtësisë menjëherë dhe në mënyrë të drejtë.

ShM ftohet që autoriteteve kompetente hetuese dhe prokuroriale në kuadër të Misionit t'iu tërheq vëmendjen kah faktorët e cekur më sipër si relevante për kompetencat e "jashtëzakonshme" të prokurorëve të EULEX-it dhe për t'i njohur ata me rëndësinë e marrjes parasysh të këtyre faktorëve në vlerësimin e tyre nëse duhet apo jo që ata të kërkojnë të marrin përsipër përgjegjësinë mbi këtë lëndë.

Ftohet ShM që të informoj Panelin rreth masave që ka ndërmarrë ajo në lidhje me këtë vendim deri me datën 19 nëntor 2016.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese